MONITORIMI I FUSHATËS ELEKTORALE TË KANDIDATEVE PËR DEPUTETE

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN 2025

Disclaimer

Ky material është plotësisht i financuar nga Agjensia Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida) dhe AWEN. Sida dhe AWEN nuk janë domosdoshmërisht dakort me opinionin e shprehur. Vetëm autori është përgjegjës për përmbajtjen.

Raport u përgatit në kuadër të projektit "Advokojmë për përfaqësim të vërtetë të grave në vendimmarrje", zbatuar nga Qendra CEDI.

Hyrje

Në vitet e fundit, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm drejt rritjes së përfshirjes të grave në politikë. Në referim të të dhënave zyrtare pas konstituimit të Legjislaturës së XI më 12 shtator 2025, gratë mbajnë rreth 39% të vendeve në Parlament, respektivisht 54 deputete nga 140 deputet në total. Pavarësisht përparimeve eventuale të përfsqësimit të grave dhe vajzave në politikë, shumë nga këto kandidate përfshihen në listat partiake për të plotësuar kuotat, ose pa qenë pjesë e proceseve vendimmarrëse kyçe.

Pavarësisht ndryshimeve të herë pas hershme të Kodit Zgjedhor dhe rritjes së mundësisë reale të përfaqësimit të grave në Kuvend ose qeverisjen vendore, strukturat partiake të partive më të rëndësishme politike në vend vazhdojnë të jetë të drejtuara nga burra.

Fenomen i zakonshëm për realitetin shqiptar është dhe gjykimi i grave aktive në politikë në mënyrë mjaft të ashpër, krahasimisht me kolegët e tyre burra. Kështu, gratë janë objekt i komenteve seksiste ose injorohen krejtësisht[1]. Për më tepër, shumë gra nuk kanë të njëjtën mbështetje ekonomike apo institucionale si homologët e tyre burra. Fushata zgjedhore kërkon para, kohë dhe rrjetëzim dhe gratë, veçanërisht ato që menaxhojnë përgjegjësi familjare, shpesh e gjejnë veten në disavantazh.

Ajo që ndjehet sot në cilësinë e përfaqësimit të gruas në parlament është një tablo komplekse. Duhet theksuar se vërehet një pamjaftueshëm prurje të reja të një niveli të lartë profesional sikurse kërkon institucioni më i rëndësishëm ligjvenës në vend dhe një mbushje e listave zgjedhore me kandidate të panjohura për komunitetin[2].

Problematikat e prezantuara më lartë dhe elemente të tjera të shoqërisë patriarkale që ende karakterizon Shqipërinë tregojnë se përmirësimi i kuadrit ligjor në lidhje me barazinë gjinore dhe veçanërisht përfaqësimin në politikë është një hap formal, i cili ka ende shumë vend për tu përmirësuar.

Në këtë kuadër Qendra për Zhvillim dhe Integrim Europian (CEDI) po zbaton projektin "Advokojmë për përfaqësim të vërtetë të grave në vendimmarrje", mbështetur nga AWEN me financim të Agjencisë Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida). Qëllimi i kësaj nisme është të kontribuojë për një përfaqësim të drejtë dhe efektiv të grave në proceset vendimmarrëse.

Shtylla kryesore e projektit konsiston në monitorimin e mediave sociale të partive politike dhe grave e vajzave kandidate për deputete, për sa i përket rëndësisë dhe vëmendjes që i është dhënë këtij grupi kandidatësh në fushatën e fundit elektorale për zgjedhjet për Kuvendin 2025.

---

[1] Karaj, Vladimir. 2025. "Pas perdes së fushatës: Gratë kandidate u sulmuan me gjuhë seksiste dhe denigruese." *Reporter.al*, 6 qershor 2025 https://www.reporter.al/2025/06/06/pas-perdes-se-fushates-grate-kandidate-u-sulmuan-me-gjuhe-seksiste-dhe-denigruese/

[2] "Zegjine Çaushi 'thumbon' Bardhin në Fier: As komisionerë s'ke gjetur, edhe Luani do të shpëtojë nga ty! Të ka bërë keq deti socialist." *Shqiptarja.com*, 8 maj 2025. Video. https://shqiptarja.com/video/zegjine-caushi-thumbon-bardhin-ne-fier-as-komisionere-ske-gjetur-edhe-luani-do-te-shpetoje-nga-ty-te-ka-bere-keq-deti-socialist

Metodologjia

Puna për hartimin e këtij raporti u konceptua dhe realizua në disa veprimtari. Studimi u vendos të hartohej bazuar në metodën cilësore, duke evidentuar dhe analizuar raporte dhe akte burimore, si dhe duke iu qasur gjashtë subjekteve politike që prodhuan deputetë gjatë Zgjedhjeve për Kuvendin 2025, me qëllim përfitimin e të dhënave cilësore. Përzgjedhja e partive objekt monitorimi u bë bazuar në numrin e deputetëve, që ka secila prej tyre në legjislaturën aktuale të Kuvendit të Shqipërisë[3].

Së pari, ekspertja e angazhuar për hartimin e këtij raporti u ndal në veprimtari kërkimore për të identifikuar materialet përkatëse burimore, statistika, aktet normative kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje.

Së dyti, në kuadër të hartimit të këtij raporti dhe krahasimit të fushatës elektorale dhe hapësirës që u është dhënë nga partitë politike grave kandidate në zgjedhjet qendrore të vitit 2025. Është monitoruar fushata në mediat sociale në kanalet e platformës META, Facebook dhe Instragram, për të gjitha grave kandidate në qarqet Berat dhe Korçë.

Në monitorim janë përfshirë partitë/koalicionet e mëdha politike dhe të vogla, më konkretish Partia Socialiste, Aleanca për Shqipërinë Madhështore, Lëvizja Bashkë, Partia Mundësia, Partia Social Demokrate dhe Partia Shqipëria Bëhet.

Përmes përdorimit të metodës krahasuese është bërë e mundur evidentimi i disa prej mangësive, ngjashmërive dhe ndryshimeve që partitë politike kanë në lidhje me hapësirën mediatike virtuale dedikuar kandidateve gra.

Evidentimi i gjetjeve kryesore dhe sfidave për t`u adresuar është përgatitur për t`u ndarë me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, organizata të shoqërisë civile, por dhe në rang më të gjerë, në

[3] Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, 2025, Kandidatët fitues, https://iemis.kqz.gov.al/results2025_v01/?lang=AL&v1=ALL

të gjithë rrjetet sociale që Qendra CEDI disponon. Gjetjet i janë përcjellë dhe tek vetë subjekteve politike kryesore me qëllim reflektimin për fushtat elektorale vijuese.

Monitorimi

Në këtë seksion do të paraqiten gjetjet kryesore mbi monitorimin e mediave sociale të partive politike dhe grave e vajzave kandidate për deputete, për sa i përket rëndësisë dhe vëmendjes që i është dhënë grave kandidate në qarqet Berat dhe Korçë. Monitorimi është ndalur në rrjetet sociale Facebook dhe Instagram të subjekteve zgjedhore, si dhe vetë kandidateve në qarqet e përzgjedhura. Paraqitja e gjetjeve në këtë kapitull është listuar vetëm bazuar në rendin alfabetik të identifikimit të partive politike dhe jo nga të qenit në pozitë ose opozitë.

Aleanca për Shqipërinë Madhështore - Partia Demokratike

Partia Demokratike (PD) cilësohet si partia e parë pluraliste, e cila fitoi zgjedhjet e para pluraliste në Shqipëri, pas rënies së regjimit komunist. Përsa i përket vlerave ideologjike dhe programeve politike PD, deklarohet të jetë një parti e djathtë, e orientuar drejt simotrave të saj si Partia Republikane (SHBA), grupi i Partive Popullore Europiane (EPP) etj.[4]

Në zgjedhjet vendore të 11 maj 2025, Partia Demokratike garoi në koalicion me Partinë e Lirisë, Partinë Republikane dhe aleatë të tjerë, duke u regjistruar në KQZ si Aleanca për Shqipërinë Madhështore. Përsa i përket monitorimit të rrjeteve sociale të AMSH[5] për qëllime të këtij raporti është vënë re nga 4 kandidate gra në qarkun Korçë është postuar në rrjete sociale vetëm 1 postim për znj. Ledina Aliolli. Vihet re se edhe nga kandidatet për deputete ka një interest e ulët për fushatën e tyre në mediat sociale. Nga monitorimi i faqeve të tyre të dedikuara për periudhën zgjedhore, znj. Ledina Aliolli kryeson me 35 postime në rrjete sociale. Më pas vijohet me znj. Brunilda Prifti me 24 postime, znj. Elsuida Vila me 5 postime dhe znj. Elenia Qirici me vetëm 2 postime gjatë gjithë periudhës së fushatës.

Ndërkohë, në Qarkun e Beratit, koalicioni Aleanca për Shqipërinë Madhështore kishte vetëm 2 kandidate për deputete. Për kandidaten znj. Valbona Doku nuk rezulton asnjë postim në mediat sociale, ku as partia dhe as vetë znj. Doku nuk kanë bërë publikime mbi kandidaturën e saj në zgjedhjet qendrore të 11 majit.

Lëvizja Bashkë

Lëvizja Bashkë është parti e së majtës demokratike, që lufton për një shtet social, zhvillim të qëndrueshëm dhe drejtësi shoqërore. Ata besojnë te demokratizimi rrënjësor i jetës së vendit dhe përfshirjes së gjerë dhe aktive të qytetarëve në proceset vendimmarrëse[6].

[4] Rreth PD - Partia Demokratike e Shqipërisë
[5] Aleanca pwr Shqipwrinw Madhwshtore
[6] https://levizjabashke.al/

Gjatë monitorimit të kryer për partinë Lëvizja Bashkë, është vënë re për qarkun Korçë kishte 4 kandidate gra. Faqja zyrtare e partisë politike ka bërë gjatë gjithë fushatës një postim prezantues për kandidaten Tea Gugo dhe një postim prezantues për znj. Vitori Çipi. Ndërkohë, nuk është bërë asnjë postim për dy kandidatet e tjera. Në rrjetet sociale të zonjave kandidate rezulton se asnjëra prej tyre nuk ka postuar gjatë fushatës elektorale.

Për Qarkun Berat ishin 3 kandidate, gra që garonin në zgjedhjet e 11 majit. Nga monitorimi i kryer, edhe për qarkun Berat është vënë re se nga partia politike janë kryer 2 postime të dedikuara për znj. Bleranda Meçi dhe një postim për znj. Esi Zaimi. Ndërkohë, për kandidaten znj. Silvana Palushi nuk është bërë asnjë postim në rrjetet sociale. Nga monitorimi i faqeve të secilës prej kandidateve të qarkut, dalim në përfundimin se kandidatja, znj. Bleranda Meçi ka bërë publike 15 publikime foto dhe video në kuadër të fushatës, kurse dy kandidatet e tjera nuk kanë kryer asnjë postim në faqet e tyre në mediat sociale.

Partia Mundësia

Mundësia është një rrjet aktivistësh i shtrirë në të gjithë Shqipërinë. Qëllimi i rrjetit është krijimi i një alternative politike moderne për një Shqipëri më të mirë. Me mundësi për secilin këtu në vëndin tonë.[7] Qëllimi i Partisë Mundësia është të heqë të gjitha barrierat që pengojnë pjesëmarrjen në politikë të grave, duke u angazhuar me vendosmëri për siguruar në të gjitha nivelet, prezencën e barabartë të grave dhe burrave në organet drejtuese dhe ekzekutive. Ajo promovon barazinë gjinore në kandidimet e ndryshme dhe përpiqet për të arritur barazinë midis burrave dhe grave edhe në pozitat monokratike institucionale brenda kësaj partie.[8]

Partia Mundësia ka pasur 5 kandidate gra për Qarkun e Korcës. Gjatë monitorimit të kryer për të pestë këto kandidate në faqen e dedikuar të Instagramit dhe Facebook të Partisë Mundësia është vënë re se nuk ka asnjë postim për asnjë nga zonjat kandidate. Gjithashtu edhe në faqet e dedikuara të kandidateve znj. Darela Ibrahimllari, znj.Enkelejda Caco, znj. Xhensina Ibi, znj. Anisa Ibrahimllari nuk ka asnjë postim në rrjetet sociale gjatë gjthë fushatës elektorale. Vetëm kandidatja znj. Najada Pedovinji ka kryer dy postime në rrjetin social Facebook.

Për qarkun e Beratit rezulton se kjo parti ka pasur 7 kandidate gra, ku ka qenë dhe numri më i lartë krahasuar me partitë e tjera. Nga monitorimi i profileve zyrtare të partisë dhe profileve të zonjave kandidate për deputete, rezulton se nuk ka asnjë postim as nga partia politike dhe as nga zonjat kandidate.

Partia Socialiste

Partia Socialiste e Shqipërisë (PS) është krijuar në qershor 1991, si një riformatim i Partisë së Punës. Ky subjekt politik ka një ideologji të qendrës së majtë, social-demokrat dhe pro 36

[7] https://mundesia.al/?section=misioni
[8] https://mundesia.al/statuti

reformues. Prej vitit 2013 PS ka mazhorancën qeverisëse në vend duke drejtuar kështu Shqipërinë për 4 mandate.[9]

Partia Socialiste ka garoi me 4 kandidate gra për qarkun e Korcës në zgjedhjet e 11 majit 2025. Nga monitorimi i kryer në rrjetet sociale të partive politike rezulton se janë kryer 28 postime për kandidaten Eni Zake dhe vetëm 1 postim për znj. Romina Kuko. Ndërkohë, që nuk rezultoi asnjë postim për kandidaten znj. Besa Spaho dhe znj. Vinjola Rota.

Faqet e dedikuara të kandidateve të subjetit politik kanë pasur postime gjatë gjithë përiudhës së fushatës elekorale. Prej prillit 2025 znj. Besa Spaho ka kryer 80 postime në rrjetet sociale të dedikuara për fushatën. Kandidatja Eni Zake ka kryer 106 postime në rrjetet sociale, ku është vënë re dhe një mbështetje nga kandidatet e tjera vajza dhe gra, po të qarkut Korçë. Znj. Vinjola Rota ka kryer 97 poste të ndryshme në rrjetet e saj sociale, kurse kandidatja Romina Kuko, gjatë gjithë fushatës elektorale ka pasur vetëm 5 postime në rrjetet e saj sociale.

Sa i përket Qarkut Berat subjekti politika ka garuar me 3 gra kandidate. Gjatë monitorimit është vënë re se nga partia politike nuk ka asnjë mbështetje për asnjë nga kandidatet në rrjetet sociale. Në rrjetet e tyre sociale, por edhe në faqet e dedikuara të menaxhuara ne emër të kandidateve rezulton se znj. Enriketa Jaho ka kryer 49 postime, znj. Matea Rexhepi 116 postime, ku është vënë re dhe një mbështetje nga asambleja rinore e Qarkut. Kandidatja Hatixhe Konomi, ka pasur 70 postime në rrjetet sociale.

Partia Social Demokrate

Partia Socialdemokrate u regjistrua më 22 prill 1991 si parti e qendrës së majtë. Në zgjedhjet parlamentare të marsit 1992 PSD fitoi 7 mandate dhe u përfaqësua në qeveri në nivel ministror dhe zv/ministror. PSD u pranua si anëtare konsultative e Internacionales Socialiste në dhjetor 1992[10].

Gjatë monitorimit të kryer në kuadër të këtij raporti është vënë re se në Qarkun Korçë kanë kandiduar 3 gra, për të cilat në rrjetet sociale të dedikuara të partisë Social Demokrate nuk ka pasur asnjë postim për t'i promovuar apo mbështetur këto kandidate.

Nga monitorimi i bërë nga ekspertët në faqet e vetë grave kandidate, është vënë re se kandidatja znj. Ana Jovan ka publikuar në rrjetet e saj sociale 36 postime, kandidatja znj. Suela Ngjela ka publikuar 15 postime, kurse kandidaja znj. Leonora Elezi nuk ka bërë asnjë postim gjatë gjithë fushatës elektorale.

Në qarkun Berat ka pasur 3 kandidate gra, përkatësisht znj. Miranda Kondakçiu, znj. Hyda Kuçi dhe znj. Joana Kumani. Për asnjë nga kandidatet për deputete, partia politike nuk ka bërë postime

[9] https://ps.al/
[10] https://psd.al/rreth-partise/

në rrjetet sociale. Edhe kandidatet znj. Hyda Kuçi dhe znj. Joana Kumani, në rrjetet e tyre sociale nuk kanë bërë postime për kandidaturën e tyre për qarkun ku garojnë. Vetëm kandidatja znj. Miranda Kondakçiu ka kryer në total gjatë gjithë fushatës elektorale 17 postime.

Shqipëria Bëhet

"Shqipëria Bëhet!" është një lëvizje qytetare, e cila aspiron forcimin e shtetit të së drejtës, mbrojtjes së të drejtave të njeriut, garës, meritokracisë dhe funksionimin demokratik të Republikës së Shqipërisë. Synimi i tyre është demokratizimi i Shqipërisë![11]

Sipas të dhënave zyrtare Shqipëria Bëhet ka propozuar 6 kandidate gra për Qarkun e Korçës. Nga të gjitha kandidatet në garë vetëm për dy prej tyre janë promovuar në rrjetet sociale të Shqipëria Bëhet dhe të partisë "Nisma thurrje". Më konkretisht janë bërë 2 postime për znj. Lindita Begolli dhe 1 postim për znj. Kesjona Ibërhasaj.

Nga monitorimi i bërë në profilet sociale të zonjave kandidate është vënë re se nuk ka asnjë postim nga kandidatet Eljona Meleq, Valdete Hakloj dhe Nertila Hoxha. Kandidatja Lindita Begolli ka kryer 51 postime në media sociale. 91 postime janë kryer nga kandidatja Kesjona Ibërhasaj dhe vetëm 3 postime nga kandidatja Enina Leço.

Në qarkun e Beratit, subjekti zgjedhor Shqipëria Bëhet ka porpozuar 3 kandidate gra për të garuar për përfaqësimin në Kuvend. Nga monitorimi i kryer është vënë re se vetëm për dy prej kandidateve të angazhuara, Rezina Bregu dhe Erisa Brushulli është bërë 1 postim në rrjetet sociale për secilën prej tyre, kurse për kandidaten Mariglena Hasalla nuk është bërë asnjë postim në asnjërën prej faqeve që partia disponon.

Duke vijuar me rrjetet sociale të vetë kandidateve, është vënë re se vetëm znj. Rezina Bregu ka publikuar 6 postime gjatë gjithë fushatës elektorale, kurse dy kandidatet e tjera nuk kanë kryer asnjë postim për promovimin e vetes apo mbështetjen e partisë politike në zgjedhjet vendore të 11 maj 2025.

[11] https://www.shqiperiabehet.al/kush-jemi

Gjetjet e monitorimit

Angazhimi i të gjithë subjekteve politike për promovimin e kandidateve gra ka gjatë fushatës për zgjedhjet për Kuvend të 11 majit 2025 ka qenë i kufizuar krahasimisht me kandidatët burra.

Një pjesë e kandidateve në listë të hapur dhe të mbyllur kanë qenë totalisht jo aktive gjatë fushatës zgjedhore.

Partia Socialiste ka shfaqur një aktivitet të lartë në lidhje me mbështetjen e kandidateve gra që gjendeshin në listën e hapur. Megjithatë, aktivitet më i lartë online është ndeshur në faqet e vetë kandidateve duke evidentuar një hendek midis angazhimit personal të kandidateve dhe promovimit nga struktura qendrore e PS.

Partia Demokratike si kryesuese e koalicionit ASHM ka treguar një mbështetje të moderuar ose të dobët të kandidatëve në rrjetet sociale. Mbështetje është treguar për një kandidate grua në listën e Korçës, ndërsa në Qarkun e Beratit mungesa ka qenë thuajse totale. Dhe vetë kandidatet nuk kanë pasur aktivitet të pasur online gjatë fushatës.

"Shqipëria Bëhet!" ka treguar një **angazhim të kufizuar zyrtar në rrjetet sociale**, duke promovuar vetëm një pjesë të kandidateve të saj. Aktiviteti më i madh ka ardhur nga vetë kandidatet në Korçë. Në Berat, promovimi online i kandidateve ka qenë tepër i moderuar.

Partia Socialdemokrate nuk ka ofruar asnjë mbështetje zyrtare në rrjetet sociale për kandidatët e saj gra në Korçë dhe Berat. Aktiviteti në rrjetet sociale ka ardhur vetëm nga disa kandidate individuale.

Partia Mundësia, ndonëse me një numër të lartë kandidatësh gra në Korçë dhe Berat, ka pasur një mungesë totale të aktivitetit në rrjetet sociale gjatë fushatës, si nga faqet zyrtare, ashtu edhe nga vetë kandidatet.

Lëvizja Bashkë pati një prani shumë të kufizuar në rrjetet sociale gjatë zgjedhjeve të 11 majit për mbështetje të kandidateve gra. Në qarkun Korçë, aktiviteti i partisë dhe i kandidateve ishte pothuajse inekzistent, ndërsa në qarkun Berat, vetëm një kandidate kreu fushatë online.

Rekomandime

KQZ[12] të kërkojë nga partitë raportim pas zgjedhjeve mbi mënyrën se si është zbatuar mbështetja për kandidatët sipas gjinisë.

KQZ të publikojë një raport të detajuar mbi përfshirjen gjinore në proceset zgjedhore, përfshirë: numrin e grave në lista, aktivitetet promovuese dhe mbështetjen institucionale gjatë fushatave.

Strukturat qendrore të partive duhet të marrin një rol më aktiv në promovimin e grave, përmes faqeve zyrtare, mediave dhe fushatave të bashkërenduara, në mënyrë që gratë të mos mbeten të izoluara në përpjekjet e tyre individuale.

Partitë të garantojnë që fondet e fushatës dhe burimet promovuese të shpërndahen në mënyrë të drejtë midis kandidatëve, pa dallim gjinor, dhe të raportojnë publikisht mbi këtë shpërndarje.

[12] Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve